



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1075 Prot.

Tiranë, më 5.8 2019

VENDIM Nr. 177, datë 31.07.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9, datë 31.07.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit *"Godina banimi dhe shërbimi 3 kat me 1 kat parkim nëntokë" rruga "Hiqmet Buzi" Liqeni i Thatë, Tiranë*-subjekti "AL-KONSTRUKSION GBI" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Znj. Iris Pojani,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit *"Godina banimi dhe shërbimi 3 kat me 1 kat parkim nëntokë" rruga "Hiqmet Buzi" Liqeni i Thatë, Tiranë*-subjekti "AL-KONSTRUKSION GBI" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Znj. Iris Pojani.
2. Subjekti "AL-KONSTRUKSION GBI" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Godina banimi dhe shërbimi 3 kat me 1 kat parkim nëntokë" rruga "Hiqmet Buzi" Liqeni i Thatë, Tiranë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al